



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERET PUBLIKE

Nr. ____ prot.

Tiranë, më 22.7.2019

Lënda: Parashtrimet përfundimtare të Komisionerit Publik në seancën gjyqësore pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit, datë 22.7.2019, për çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit znj. Nertina Kosova, magjistrate/gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Referuar nenit 302 të Kodit të Procedurës Civile, pasi u administruan, shqyrtuan dhe iu nënshtruan debatit gjyqësor të gjitha shkaqet e ankimit, prapësimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, Komisioneri Publik parashtron pretendimet e tij përfundimtare në këtë gjykim.

Në vlerësim të Komisionerit Publik, shqyrtimi gjyqësor nga ana e Kolegjit mbi bazën e shkaqeve të ankimit, në referencë të nenit 179/b, pika 5, i Kushtetutës, nenit C, pika 2, neni F, pika 2 dhe 3 e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, evidentoi disa mangësi të konstatuara gjatë hetimit të çështjes nga ana e Komisionit.

Këto mangësi u vërejtën në disa elemente të kontrollit të kriterit të pasurisë si: saktësia dhe mjaftueshmëria e deklaramit të pasurisë (periodike/Vetting), përmbushja e detyrimeve financiare, hetimi në mënyrë shteruese i burimit të ligjshëm të krijimit të pasurisë, të ardhurave dhe likuiditeteve. Ky hetim në rastin konkret ishte i domosdoshëm, si për sa i takon subjektit të rivlerësimit, ashtu edhe personave të lidhur/të tjerë të lidhur me të, me qëllim krijimin e bindjes mbi besueshmërinë, në vlerësimin e këtij kriteri.

Komisioneri Publik vlerëson se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje, në vlerësimin e përgjithshëm të procedurave të procesit të rivlerësimit, provoi nevojën që për raste të ngjashme, kur rrethanat faktike dhe juridike e lejojnë, merita dhe kërkimi i ankimit të Komisionerit Publik të jetë alternativ kundrejt juridiksionit kontrollues të Kolegjit, pasi sikundër ky rast dëshmoi, të gjitha shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik, në referencë të nenit 52, të ligjit nr. 84/2016, gjetën përgjigje nga rreth 70 prova të reja, të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë shqyrtimit gjyqësor¹.

Ky fakt, në vlerësimin e Komisionerit Publik, e bën të justifikuar vendimmarrjen e këtij trupi gjykues për lënien në fuqi të vendimit nr. 43/2018, të Komisionit, por me një tjetër arsytim. Komisioneri Publik vlerëson se vendimi përfundimtar i këtij trupi gjykues duhet të përfshijë në

¹ Subjekti ka paraqitur dhe janë administruar, përfshirë këtu edhe prova të reja: (i) 61 akte (gjithsej 365 fletë), në seancën e datës 12.6.2019; (ii) 8 akte (gjithsej 32 fletë), në seancën e datës 3.7.2019 dhe (iii) 2 akte lidhur me shpenzimet e subjektit për udhëtimet jashtë vendit, në seancën e datës 19.7.2019.

arsyetimin e tij ligjor çështjet e patrajuara gjatë shqyrtimit të çështjes në Komision, të cilat u hetuan gjatë gjykimit, si rrjedhojë e shkaqeve të ngritura në ankim. Çështje të tilla këto si: cilësimi i të atit të subjektit si person tjetër i lidhur, në cilësinë e kryefamiljarit, analiza financiare e kryer për këtë qëllim dhe nevoja në përcaktimin drejt të gjendjes së fakteve, që kanë lidhje me kontrollin dhe burimin e ligjshëm të pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe personave të tjerë të lidhur me të, nën dritën e provave të reja të administruara.

Duhet mbajtur në konsideratë fakti se edhe vetë subjekti i rivlerësimit i çmoi shkaqet e ankimit të ngritura nga Komisioneri Publik në cilësinë e barrës së provës dhe, me qëllim rritjen e efektivitetit të procesit, bazuar në nenin 48 dhe 52 të ligjit nr. 84/2016, kërkoi ajo vetë çeljen e hetimit gjyqësor dhe administrimin e provave të reja.

Komisioneri Publik, në vlerësim të fuqisë provuese, të provave të administruara, në raport me secilin shkak ankimi, parashton si vijon:

I. Lidhur me verifikimin e burimit të ligjshëm për krijimin e të ardhurave të ligjshme në vlerën 1.000.000 lekë, të cilat kanë shërbyer në krijimin e pasurisë së deklaruar nga subjekti, apartament banimi (rr. “*.***”, Tiranë)**

Për këtë shkak ankimi, Komisioneri Publik, në zbatim edhe të orientimit të dhënë nga Kolegji i Posaçëm i Apelit në vendimin (JR) nr. 7/2019, vlerësoi se hetimi, analiza financiare dhe arsyetimi i Komisionit ishte jo e plotë dhe, për rrjedhojë, nuk dilte në konkluzione të bazuara në një interpretim të drejtë të ligjit nr. 84/2016.

Nevoja për kryerjen e një analize të re financiare ishte evidente, në vlerësimin e burimit të ligjshëm të këtyre të ardhurave të ligjshme, duke kualifikuar të atin e subjektit të rivlerësimit, z.***.***, si person tjetër të lidhur, në cilësinë e tij si kryefamiljar i familjes Kosova, sipas deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe gjendjes familjare të saj, vërtetuar nga aktet e gjendjes civile.

Kësaj kërkesë procedurale, Kolegji, në konsideratë edhe të provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit², iu përgjigj duke kryer dhe vënë në dispozicion të palëve një analizë financiare paraprake, hartuar në tri variante lidhur me zërin “shpenzime jetësore”, e për të cilën Komisioneri Publik mbajti qëndrim në seancën e mëparshme.

Në vlerësimin e Komisionerit Publik, kjo analizë financiare bëri të mundur verifikimin e origjinës dhe burimit të ligjshëm të të ardhurave të ligjshme prej 1.000.000 lekë, të përdorur nga ana e subjektit sipas kontratës së sipërmarrjes së shtatorit 2006, në favor të shoqërisë “***” sh.p.k, burim i cili, sipas kësaj analize, identifikohet qartësisht në të ardhurat e ligjshme të familjes Kosova, administruar nga personi tjetër i lidhur, i ati i subjektit, z.***.***.

Komisioneri Publik nënvizon faktin se në këtë analizë financiare, një pjesë e bursës studentore, që subjekti i rivlerësimit kishte përfituar në vitin 1999, nga MPJ e Republikës së Italisë, ishte përfshirë në zërin e të ardhurave të ligjshme. Provat e reja të administruara në këtë gjykim nga ana e subjektit të rivlerësimit, të marra nga sistemi bankar italian, të vërtetuara dhe të marra në formën e duhur nga autoritetet italiane,³ provuan faktin e kursimit të shumës përkatëse, përpara datës së kthimit të subjektit në atdhe.

² Referohuni në legjendën e provave, të numërtuara nga 1-9.

³ Referohuni në legjendën e provave, të numërtuara, nr. 7 dhe 8, paraqitur në seancën e datës 12.6.2019, si dhe 3 prova të reja, paraqitur nga subjekti në seancën e datës 3.7.2019.

II. Lidhur me nevojën për verifikimin e rrethanave faktike e juridike dhe lidhja e tyre me subjektin e rivlerësimit, për transfertën bankare të kryer nga i vëllai (burimi i ligjshëm)

Në përgjigje të këtij shkaku ankimi dhe pyetjeve të dala nga shqyrtimi gjyqësor i Kolegjit, subjekti i rivlerësimit prapësimet e saj i shoqëroi me aktet përkatëse, për të cilat, sipas nevojës së hetimit, bazuar në nenin 48 dhe 52 të ligjit nr. 84/2016, kërkoi administrimin e tyre në cilësinë e provës⁴.

Komisioneri Publik, sikundër mbajti qëndrim edhe në seancën e datës 21.6.2019, vlerën provuese të këtyre akteve i çmoi me rëndësi, pasi ato rrëzuan çdo dyshim të arsyeshëm mbi këtë transfertë bankare. Aktet e reja të administruara mbi këtë shkak ankimi provuan se transfertat e kryer nga i vëllai i subjektit të rivlerësimit, në një llogari bankare jashtë vendit, në asnjë rrethanë faktike e ligjore nuk mund të lidhet me subjektin e rivlerësimit, të ardhurat e saj apo familjarëve të saj, me qëllim vlerësimin e origjinës dhe ligjshmërisë së burimit të tyre.

Në vlerësimin e Komisionerit Publik, provat e administruara për këtë shkak ankimi, më së paku treguan se vëllai i subjektit të rivlerësimit ka vepruar si përfaqësues i interesit tregtar të shoqërisë “***” sh.p.k, pasi në to identifikohet si llogaria bankare dërguese, ajo pritëse, përfituese në Mbretërinë e Bashkuar dhe qëllimi i saj. Situata faktike kjo e shoqëruar me një sërë veprimesh të tjera financiare, të kryera dhe nënshkruara nga vëllai i subjektit të rivlerësimit për llogari të shoqërisë “***” sh.p.k, si deklarata doganore, fatura tatimore, mandatpagesa etj.

Kjo vijimësi e procesit të provueshmërisë së fakteve të sipërcituara, në vlerësimin e Komisionerit Publik mbështet pretendimin e subjektit të rivlerësimit, se transfertat bankare e mësipërme nuk ndikon në vlerësimin e kriterit të pasurisë së rastit konkret.

III. Lidhur me huan e marrë nga i ati i subjektit, z.*.***, nga shtetasi z.***.***.**

Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të këtij shkaku ankimi, bazuar në nenin 48 dhe 52 të ligjit nr. 84/2016, kërkoi administrimin e një deklarate noteriale të palëve të përfshira në marrëdhënien e huas, një sërë aktesh të lëshuara nga ZVRPP Elbasan, si dhe kontrata të ndryshme sipërmarrje të nënshkruara nga huadhënësi, shtetasi ***.***, me qëllim vërtetimin e kohës së marrjes së kësaj huaje, qëllimin e deklaruar, origjinën dhe burimin e ligjshëm të huas⁵.

Komisioneri Publik, në vijim të qëndrimit të tij në seancën e datës 21.6.2019, vlerëson se këto akte të paraqitura nga subjekti, të analizuara në harmoni edhe me aktet e tjera, i përgjigjen dhe provojnë të kundërtën e shkakut të ankimit, lidhur me kohën e marrjes së një pjese të huas në *cash*, moment i cili do të përcaktonte edhe vlerësimin ligjor, nëse kjo hua do të trajtohet ose jo si e marrë nga personi tjetër i lidhur, i ati i subjektit të rivlerësimit, në kuptim të ligjit nr. 84/2016.

Për Komisionerin Publik, aktet e administruara provojnë se nuk ka ndonjë indicie apo rrethanë faktike që të përfshijë, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, subjektin e rivlerësimit në këtë marrëdhënie huaje, me qëllim vlerësimin e besueshmërisë së saj në raport me procesin e rivlerësimit.

⁴ Referohuni në legjendën e provave, të numërtuara nga nr. 10-48, paraqitur në seancën e datës 12.6.2019, si dhe 3 prova të paraqitura në seancën e datës 3.7.2019.

⁵ Referohuni në legjendën e provave, të numërtuara nga nr. 49-58, paraqitur në seancën e datës 12.6.2019.

IV. Për likuiditetet e padeklaruara të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur/tjerë të lidhur me të

Në ngritjen e këtij shkaku ankimi, Komisioneri Publik është bazuar në dokumentacionin bankar, ku vërehet se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/tjetër i lidhur me të, i ati, nuk kanë deklaruar plotësisht e saktësisht likuiditetet, në formën e llogarive bankare, bashkëmërore, në deklaratat periodike vjetore, konstatim ky deri në momentin kur subjekti i rivlerësimit, si në aspektin fizik dhe atë ligjor, ndahet nga trangu familjar dhe nuk deklaron llogari bashkëmërore.

Duke mos përsëritur faktet, rrethanat dhe qëndrimin e Komisionerit Publik për këtë shkak ankimi, përfundimisht vërtetohet se likuiditetet e deklaruara dhe ato të gjendura në llogaritë bankare kanë si burim të vetëm të ardhurat e ligjshme nga paga e subjektit të rivlerësimit (burim i ligjshëm), bazuar në kërkesat e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar. Me gjithë këto rrethana fakti dhe ligjore, subjekti gjendet në kushtet e deklarimit të pasaktë.

Për sa i përket llogarive bankare të padeklaruara të të atit deri në vitin 2010, të cilat gjithashtu ishin pjesë e shkaqeve të ankimit të Komisionerit Publik, analiza financiare e Kolegjit tregoi se këto likuiditete në llogari bankare ishin krijuar nga të ardhurat e përbashkëta të ligjshme të familjes Kosova. Gjithashtu, referuar pasqyrave të lëvizjeve bankare të të atit, konstatohet se z.***.***, likuiditetet të cilat deri në vitin 2005 i kishte të investuara në bono thesari, në shumën 1,900,000 lekë, në vitin 2006 i kalon në llogari depozite, duke zvogëluar shumën e depozituar në 1,100,000 lekë. Periudha e zvogëlimit të depozitës, pra viti 2006, përkon me periudhën kur i ati i subjektit ka kontribuar në dhënien e shumës 1,000,000 lekë, për pagesën e apartamentit⁶. Lëvizjet bankare të likuiditeteve të të atit vërtetojnë pagesën dhe burimin e shumës së vënë në dispozicion nga familja Kosova për subjektin N. K.

Komisioneri Publik, për këtë gjendje të konstatuar, mban në konsideratë se objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit, përfshin si kontrollin e saktësisë dhe atë të mjaftueshmërisë së deklarimeve në deklaratat periodike dhe atë Vetting, ku në çdo rast subjekti i rivlerësimit ka detyrimin të shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë së tij dhe të personave të lidhur/të tjerë të lidhur me të (pasuri e paluajtshme/e luajtshme/likuiditete).

Në vështrim të këtij detyrimi ligjor, dhe për sa kohë që në rastin konkret nuk ka rrethana apo fakte që të justifikojnë dyshime mbi ligjshmërinë e burimit të krijimit, pasaktësitë në deklaratat periodike të subjektit të rivlerësimit, znj. Kosova nuk mund t’i jepet pesha dhe roli, e tillë sa, që në zbatim të dispozitave kushtetuese e atyre ligjore të gjejë zbatim masa disiplinore.

V. Lidhur me shkakun “Çështje të tjera”, trajtuar në prg. 22 të ankimit

Komisioneri Publik, bazuar në provat e administruara nga Komisioni, konstatoi se personi tjetër i lidhur, i ati i subjektit të rivlerësimit, në vitin 2000, kishte blerë një automjet me targë

⁶ Nga verifikimi i pasqyrave të lëvizjeve bankare të ***.*** Bank, konstatohet se z. ***.***, në datë 4.9.2006, ka tërhequr shumën 600,000 lekë, e cila përkon me datën e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes dhe datën e likuidimit të shumës për blerjen e apartamentit nga subjekti i rivlerësimit.

, në shumën 880.000 lekë, dhe se në fashikullin e DPSHTRR-së, ndër të tjera, gjenden të administruara akte nga AMF-ja (shkresa nr. prot., datë ***.1.2018), të cilat konfirmonin se për këtë automjet, për subjektin e rivlerësimit janë lëshuar policat e sigurimit TPL gjatë periudhës 2007 - 2009. Në dosje të Komisionit gjenden dhe një sërë aktesh nga DRSHTRR Elbasan, sipas të cilave subjekti kishte pasur këtë automjet në pronësi (shkresë nr.*** prot., datë ***.2.2018, shkresa nr.*** prot., datë ***.3.2018 dhe shkresa nr.*** prot., datë ***.4.2018).

Referuar këtyre akteve, rezultonte se subjekti i rivlerësimit nuk kishte deklaruar në deklaratat respektive vjetore këtë automjet në pronësi apo përdorim, si dhe burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie.

Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të nevojave për hetim të kërkuara nga Komisioneri Publik për këtë shkak ankimi, bazuar në nenin 48 dhe 52 të ligjit nr. 84/2016, së bashku me shpjegimet e datës 12.6.2019, paraqiti një sërë aktesh⁷, nga ku rezulton se AMF-ja dhe kompania siguroese kanë pranuar se ka pasur një gabim material në prezantimin drejt të faktit dhe se për periudhat respektive rezulton i siguruar vetëm personi tjetër i lidhur, i ati i subjektit të rivlerësimit⁸.

Lidhur me burimin e ligjshëm për blerjen e këtij automjeti, gjatë shqyrtimit gjyqësor, subjekti i rivlerësimit dorëzoi dhe kërkoi nga Kolegji administrimin në cilësinë e provës të disa akteve⁹, nga vlerësimi i të cilave Komisioneri Publik çmon se ato provojnë, sikundër rezultoi dhe nga analiza financiare paraprake e Kolegjit, se personi tjetër i lidhur, i ati i subjektit të rivlerësimit, nën regjimin e ekonomisë së përbashkët familjare, ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e këtij automjeti.

VI. Kërkimi përfundimtar

Nga sa u parashtrua më sipër, Komisioneri Publik, në vlerësimin tërësor të të gjithë provave të administruara gjatë shqyrtimit dhe hetimit gjyqësor të kësaj çështjeje, i kërkon këtij trupi gjykues lënien në fuqi me një tjetër arsyetim të vendimit nr. 43, datë 18.7.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, znj. Nertina Kosova.

KOMISIONERI PUBLIK Florian BALLHYSA

⁷ Referohuni f.24 dhe në vijim të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, të datës 12.6.2019.

⁸ Nga AMF-ja është saktësuar se nga policat e sigurimit TPL me numër serial ***, periudhë sigurimi ***.4.20017 deri ***.4.2008 dhe polica TPL me numër serial ***, periudhë ***.4.2008 deri ***.4.2009, për mjetin me *** targë, rezulton i siguruar vetëm z. ***.***, si dhe shkresa përmes së cilës shoqëria *** ka konfirmuar se policat janë lëshuar për mjetin ***, me të siguruar z.***.***.

⁹ (i) Akti-marrëveshje për premtim shitblerje toke bujqësore nr.*** regj., datë ***.6.1999; (ii) Vërtetime të Këshillit të Rrethit Elbasan, datë ***.6.1999, në emër të *** e ***.***;

(iii) Akti i marrjes së tokës në pronësi në emër të ***.*** e ***.***; (iv) Kërkesë e Këshillit të Qarkut, datë ***.5.2016; (v) Shkresë nr.*** prot., datë ***.5.2016 e Këshillit të Qarkut Elbasan; (vi) Autorizim, datë ***.5.1993, i Këshillit të Rrethit Elbasan dhe (vii) Relacion dhe kërkesë, datë ***.7.1993. Përfundimisht, regjistrimi i kalimit të pronësisë, të cilit i referohet akti i vitit 1999, është kryer në vitin 2014, konform legjislacionit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, lëshuar certifikata e pronësisë, për rrjedhojë janë shlyer dhe detyrimet tatimore përkatëse.